



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 21.11.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 16.11.2022, të parashtruar nga Grupi i Operatorve Ekonomik N.P.SH. "Eltoni Com"& "PE-VLA-KU" shpk, Dega në Kosovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull : "Rregullime dhe mirëmbajtje të shkollave", Nr. i prokurimit- 632-22-9759-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-102-521, nxjerr:

V E N D I M

- 1. Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Grupit të Operatorve Ekonomik N.P.SH. "Eltoni Com"& "PE-VLA-KU" shpk, Dega në Kosovë, e dt.16.11.2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Rregullime dhe mirëmbajtje të shkollave", Nr. i prokurimit- 632-22-9759-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-102-521., kundër NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, te AK –së, të datës 10.11.2022, të publikuar në platformën elektronike të KRPP.
- 2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES të publikuar me datë 10.11.2022;**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

A r s y e t i m

Me dt.16.11.2022, Grupi i Operatorve Ekonomik N.P.SH. "Eltoni Com"& "PE-VLA-KU" shpk, Dega në Kosovë., ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: "Rregullime dhe mirëmbajtje të shkollave " , Nr. i prokurimit- 632-22-9759-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-102-521.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 21.11.2022, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj se operatori ekonomik i propozuar për kontratë, ka çmime abnormalisht të ulta dhe ka dështuar në përgjigjet për sqarimet e kërkuara nga Autoriteti kontraktues, nuk është i bazuar sepse sqarimet dhe kalkulimet e shpenzimeve të ofruara nga operatori ekonomik në fjalë kanë qenë të mjaftueshme për Autoritetin kontraktues.

Pretendimi juaj se operatori ekonomik i propozuar për kontratë, nuk ka paraqitur autorizim për nënshkruerit e deklaratës nën betim dhe dokumenteve tjera, Autoriteti kontraktues sqaron se ky pretendim i juaji është i pabazuar, sepse sepse një gjë e tillë nuk është kërkuar në FDT dhe në certifikatën e biznesit figuron si person i autorizuar

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**


Faton Gutaj
Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;
Arkivit të Komunës